



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Osmanisht I

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 10 leksione, 30 seminare

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studimi i osmanishtes – viz. turqishtja e periudhës osmane – bart rëndësi të veçantë jo vetëm në rrafshin e kulturës dhe historisë, por, më së pari e mbi të gjitha, në rrafshin gjuhësisë. Në gjirin e turqishtes moderne, – viz. turqishtes që flitet në Republikën e Turqisë, – osmanishtja zë një vend jo thjesht të rëndësishëm, por edhe thelbësor, për aq sa në pjesën më të madhe është një prurje dialektike e saj..

Objektivat specifike lëndore:

1.Njohja mesë pari e paleografisë dhe më pas e gramatikës së osmanishtes është *conditio sine qua non* për zbërthimin dhe kuptimin e dukurive gjuhësore që vërehen në turqishten moderne, qoftë kjo në rrafshin leksikor, qoftë në atë morfologjik dhe sintaksor, duke ndriçuar qartësisht jo vetëm zhvillimet e saj diakronike, por edhe elementët e dendur të kontaktit gjuhësor mes saj dhe gjuhëve të tjera, në mënyrë më të veçantë arabishtes dhe persishtes, me të cilat osmanishtja ka të përbashkët shumë më tepër sesa thjesht dhe vetëm alfabetin..

Rezultatet e pritshme:

- 1.Njohë dhe përdorë elementet themelore të paleografisë osmane, përfshirë alfabetin arab të përdorur në osmanisht dhe veçoritë grafike të shkrimit të saj.
- 2.Lexojë dhe deshifrojë tekste të shkruara në osmanisht, duke përdorur aftësi të fituara në fushën e paleografisë dhe njohuritë gramatikore.
- 3.Kuptojë strukturat gramatikore të osmanishtes, përfshirë morfologjinë dhe sintaksën, dhe të bëjë krahasime të mirëfillta me turqishten moderne.
- 4.Analizojë dukuritë gjuhësore në turqishten bashkëkohore si rezultat i zhvillimeve historike dhe ndikimeve nga osmanishtja.
- 5.Identifikojë ndikimet e arabishtes dhe persishtes në osmanisht, si në fjalor ashtu edhe në strukturë, duke kuptuar natyrën e kontaktit gjuhësor ndërmjet këtyre gjuhëve.